

13.07.2021

Ora18:05

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-----------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj, M.Koja |
| Parti | Politike: | PD, LSI, PS, PDIU. |

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator, e cila është njoftuar publikisht. U është njoftuar anëtarëve, përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, mediave. Mbledhja është thirrur pas njoftimit zyrtar të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, ka në rendin e ditës një projektvendim “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021”. Të pranishëm janë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, të pranishëm janë gjithashtu përfaqësues të subjekteve zgjedhore, përfaqësues të administratës të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të mediave. Para se të fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit që kemi në rendin e ditës, sipas rregullores për organizimin dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

funksionimin e Komisionit Rregullator, po ju drejtohem kolegëve, anëtarë të Komisionit Rregullator, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të trajtuar Kolegë?! Nëse jo fillojmë me projektaktin “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.04.2021”. Nga ana e administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Sekretari i Përgjithshëm, zoti Merkaj, ju lutem një prezantim të shkurtër të projektaktit dhe relacionit bashkëlidhur tij.

Z. Y. Merkaj: Presidenti i Republikës në dekretin nr.11700, datë 09.06.2020, ka caktuar datën 25.04.2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë. Në datën 25.04.2021 në 12 Zonat e Administrimit Zgjedhor, në Republikën e Shqipërisë, u zhvilluan zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë. Pas përfundimit të procesit të votimit Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miratoi rezultatin e votimit për çdo zonë zgjedhore, mbi bazën e tabelave përmbledhëse të rezultateve të zonave të administrimit zgjedhor dhe tabelave të rezultatit të qendrës së votimit të përçuara nga anëtarët e grupit të numërimit. Për 9 raste, vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, për miratimin e tabelës përmbledhëse të rezultatit të votimit për zonat zgjedhore, janë ankimuar në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve. Në përfundim të shqyrtimit nga KAS, të nëntë vendimet janë ankimuar në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Në përfundim të procesit të ankimimeve dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në KAS dhe në Kolegjin Zgjedhor, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të neneve 162 dhe 163 të Kodit Zgjedhor, ka përlllogaritur shpërndarjen e mandateve, ndërmjet koalicioneve zgjedhore dhe partive politike, të cilat garuan më vehte, për çdo zonë zgjedhore. Pas shpalljes së rezultatit për shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore dhe në përfundim të procedurave ankimore dhe kalimit të afateve ligjore të ankimit në Kolegjin Zgjedhor, në mbështetje të nenit 20, pika 2 shkronja “d”

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

dhe nenit 167 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shpall me vendim rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Rezultati përfundimtar i zgjedhjeve i shpallur nga Komisioni Rregullator duhet të përfshijë numrin e votave, numrin e mandateve dhe listën emërore të deputetit të zgjedhur për çdo subjekt, në çdo zonë zgjedhore, si dhe numrin e votave, numrin e mandateve, listën emërore të deputetëve të zgjedhur, për çdo subjekt në shkallë vendi. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim, miratim si dhe listat nga njëshi tek gjashta për subjektet dhe kandidatët, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Kemi ndonjë pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm, apo të vijojmë me shqyrtimin e diskutimeve në parim për projektaktin? Dakord, nëse jo, fillojmë me diskutimin në parim të projektaktit. Në këtë fazë të shqyrtimit, së pari e kanë fjalën anëtarët e Komisionit Rregullator, më tej përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore, nëse dëshirojnë të diskutojnë në parim. Kolegë?! Po zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Po, faleminderit! Të nderuar kolegë, të nderuar pjesëmarrës në këtë proces, i cili përvijoi prej muajve të tërë, me një gamë të gjerë aktesh, me një gamë të gjerë diskutimi, debati etj. Sot kemi në tryezë për shqyrtim dhe miratim aktin final të formalizimit, të përmbylljes së procesit zgjedhor. Vërtet ky akt i përgatitur nga administrata, në dukje ka një përmbajtje në pak rreshta, por në thelb ky akt është pasqyra e pazëllit të tërësisë së akteve të miratuara nga KQZ. Pra, jo vetëm nga ne si Komision Rregullator, por dhe nga dy organet e tjera. Është efekt i pazëllit në drejtim të zbatimit dhe respektimit të tyre nga vetë KQZ, por edhe nga aktorët e përfshirë në këtë proces. Siç e dimë janë jo vetëm partitë politike pra, subjektet zgjedhore, por njëkohësisht edhe administrata apo institucionet, të cilat u përfshinë në këtë proces. Ky akt në pritshmëritë e mia në fakt, duhet të ishte gjurma finale e dëshmisë së suksesit dhe arritjes së


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

standarteve më të larta të demokracisë në fushën e zgjedhjeve. Po ashtu duhet të ishte dëshmi e respektimit të pandikueshmërisë në shprehjen e vullnetit të lirë të qytetarëve. Dëshmi e respektimit të detyrimit të mbajtjes larg nga procesi, të administratës, të mosabuzimit me fondet publike, të të mirave publike, asetëve dhe njëkohësisht mosndikimin e pushteteit apo e të ardhurave nga institucionet shtetërore, qendrore apo vendore. Gjithashtu duhet të ishte edhe dëshmi e respektimit në maksimum të parimit të transparencës, me qëllim që procesi të quhej proces i arrirë në kuptimin e Kodit Zgjedhor, por edhe në kuptim të parimit të ligjshmërisë. Pa dyshim kolegë, në meritë të integritetit dhe profesionalizmit, jemi përpjekur që përmes diskutimit, debatit të normojmë akte, të cilat në përmbajtje mendoj se ishin progres dhe arritje në fushë. Pavarësisht kësaj, këto akte nuk u zbatuan apo aplikuan siç duhet. Kjo padyshim që duhet të sjellë sigurisht pasojë në këtë akt, apo në përmbajtjen dhe rezultatin që presim prej tij. Sigurisht ka sjellë ndikim në pritshmërinë për zgjedhje të lira e të ndershme. Kujtoj këtu aktin për veprimtarinë e ndaluara, i cili u shpërfill tërësisht nga administrata qendrore dhe vendore. Dëshmi e qartë, siç e dini sepse jeni dëshmitarë, janë kronikat mediatike, faktet e sjella nga subjektet zgjedhore, kallëzimet apo dëshmitë e dorëzuara nga subjektet zgjedhore në institucionet ligjzbatuese. Kjo jo më larg... mos të shkojmë më larg se Tirana, kemi shembullin e kryetarit të Bashkisë Tiranë, i cili u bë një subjekt i procesit të verifikimit përmes këtij akti apo më gjerë. Gjithashtu, dua të kujtoj këtu fenomenin e patronazhimit, patronazhimit të pa kërkuar dhe e theksoj apo e përsëris të pa kërkuar, i cili ndryshon nga të dhënat vullnetare që kërkon të përcjellë çdo zgjedhës pranë partisë ku aderon, pranë partisë ku ka preferencën të çojë votën, apo që simpatizon. Edhe ky fenomen është zbuluar mediatikisht. Përmes këtij fenomeniurvejuesi monitoronte dhe merrte të dhëna personale, sociale, familjare për çdo individ me qëllim ndikimin dhe orientimin e votës drejt partisë në pushtet. Ju e dini mirë rastin e denoncuar nga unë, pra


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

patronazhistin tim personal dhe trumbetimin që i bëra këtij rasti, jo si ndikim individual, por si ndikim social dhe njëkohësisht si një fenomen, i cili po ndikonte dhe po linte gjurmën më negative, në historinë e procesit zgjedhor. Gjithashtu dua të kujtoj abuzimin me fondet publike, të raportuara mediatikisht, por njëkohësisht i gjeni edhe në raportin paraprak të OSBE/ODIHR. Kujtojmë nëntëqind e njëzetë e gjashtë milion lekët, e shpërndara javën e fundit të procesit zgjedhor. Pra, data 25 prill, ishte data e cila i paraprinte “qokës” le të themi, të shpërndarë në Prefekturën Durrës qytetarëve, të cilët merrnin një shpërblim të ndryshëm nga ai i targetuar teknikisht, për dëmin që kishin pësuar në vitin 2019, pra dy vite më parë. Pse pikërisht mbas datës 25, ky shpërblim u ndërpre si me thikë? Kjo më çon të mendoj, ashtu si mediat kanë analizuar, nuk shkoj më larg analizës së tyre, sepse e gjej me vend. Një ndikim absolut në procesin zgjedhor dhe në votën e lirë. Nuk dua të lë pa përmendur punësimet e panumërta, të kryera në shkelje të ligjit dhe të aktit të Komisionit Rregullator. Aktit për veprimtaritë e ndaluara nga pushteti vendor, nga institucionet apo entet shtetërore, në nivel qendror apo vendor. Të cilat nuk na dhanë llogari asnjëherë. Kujtoj këtu kërkesën time drejtuar administratës së KQZ-së, për të marrë informacion mbi punësimet e kryera përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Dua të kujtoj madje dhe përdorimin e parasë së pisët nga parti të cilat pa program dhe pa elektorat, thyen çdo rregull të standarteve klasike të funksionimit, të garimit politik dhe për më tepër të garimit të ndershëm. Jemi dëshmitarë kolegë, për gjithë sa më sipër, madje dhe i denoncimeve të shumta nga subjektet zgjedhore, partitë politike, pranë organeve të zbatimit të ligjit, prokurosisë, SPAK-ut për të parandaluar sa të ishte e mundur... Pata një rol aktiv duke kërkuar përmes administratës sonë, t’i drejtojë dhe t’i adresojë Prokurorit të Përgjithshëm për incertivimin dhe vënien në lëvizje të prokurorive kompetente për t’i shtyrë në përshpejtim këto raste, me qëllim që të jepnin një efekt para procesit zgjedhor.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

Kërkova që t'i drejtohem edhe SPAK, se çfarë është duke bërë apo çfarë informacioni mund të na përcillte në drejtim të këtyre kallëzimeve, por nuk patëm asnjë rezultat apo asnjë përgjigje. Efekti post, sepse çdo tëndodhte me këto kallëzime post, nuk besoj se do të kishte ndonjë ndikim për atë që na kishim si objektiv apo si synim për të arritur drejt një standarti më të lartë në këto zgjedhje. Kam kërkuar gjithashtu dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nga drejtuesi i e-Albania apo nga Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore, për efektin që do të sillnin apo mënyrën se si u ishin servirur patronazhistëve të dhënat personale, por as këtu nuk mora asnjë përgjigje. Gjithashtu, do të evidentoja mes gjithë kujtesave të tjera edhe masakrën e numëruesve. Një rast po e sjell, megjithëse partitë politike i kanë kontestuar apo i kanë sjellë në vëmendje të organit tonë homolog apo paralel KAS, për t'i shqyrtuar individualisht këto raste. Po e sjell rastin e Qarkut Gjirokastrë ku Lëvizja Vetëvendosja bëri publike në media, por edhe në KQZ të gjithë dokumentimin për cënimin e votës me zë dhe me figurë. Gjithashtu nuk mund të anashkalojmë, për as edhe një moment, faktin që nga organet administrative, verifikimi i pritshmërisë së procesit zgjedhor, u mohua respektimi i parimit të transparencës, pra i marrjes së provave. E si mund të flasim për një proces i cili, në të cilin, ose për të cilin është ruajtur apo respektuar parimi i ligjshmërisë. Gjithashtu e si mund të mos përmendim sjelljen e trupit gjyqësor të Kolegjit Zgjedhor, në raport përsëri me respektimin e parimit të transparencës dhe njëkohësisht respektimin e realizimit të një procesi të garantuar ligjor, ku palëve u respektohet çdo e drejtë dhe mbi të gjitha publikut i bëhet transparencë çdo provë apo çdo e dhënë e kërkuar nga palët e interesuara. Janë të gjitha këto arsye, të cilat më bëjnë të mbetem strikte respektimit të parimit të integritetit, etikës profesionale për të mos dakordësuar me çfarë synon të përmbushë ky akt në nivel parimor, përmbajtësor e sasior, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



Znj. I. Nano: Faleminderit zonja Vukaj! Kolegë, zoti Çakaj.

Z. M. Çakaj: Faleminderit e nderuar! Të nderuar kolegë, të nderuar përfaqësues të partive politike, i nderuar staf i administratës së KQZ-së. Në vijim të asaj çfarë tha dhe zonja Vukaj, vlen të theksojmë, ashtu siç e kemi theksuar gjatë gjithë mbledhjeve që kemi zhvilluar së bashku se një nga aktet më të rëndësishme që ky komision ka miratuar është akti mbi veprimtaritë e ndaluara. Në fakt edhe unë dhe zoti Çaka këtu kemi qenë në cilësinë e ekspertit në Këshillin Politik dhe besoj e kujton mirë se një nga kërkesat kryesore të opozitës, nga e cila hoqi dorë në fakt ishte... qeveri teknike. Ishte pikërisht garancia që u fut në Kodin Zgjedhor, e nenit 91 mbi veprimtaritë e ndaluara. Duke pasur parasysh se të gjitha palët, do të garojnë në kushte të barabarta. Pra, do të kemi standarte dhe kushte të barabarta. Ajo u materializua në vendimin tonë nr. 9 dhe prezumoi që të zbatohet së pari nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mënyrën se si ishte konceptuar. Pra, u hartua nga ky komision do të duhej të zbatohet si nga Komisioneri, si nga organi tjetër KAS, por nga të gjithë organet e pushtetit qendror dhe pushtetit vendor. Kolegia e përmendi në mënyrë të detajuar, por unë po përmend vetëm disa pika, të cilat në gjykimin tim personal, ndikojnë thelbësisht në rezultatin e zgjedhjeve. Pra, në parim për miratimin e këtij akti, do të duhet të ishin në kushte të thjeshta. Thjesht do të duhet të miratonim në mënyrë formale rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. A është ky rezultati përfundimtar i zgjedhjeve?! Pasqyra reale e votave, pasqyra reale e vullnetit të zgjedhësve shqiptarë?! Unë gjykoj se jo. Janë katër arsye thelbësore, të cilat kanë ndikuar dhe kanë prodhuar këtë rezultat që për mua nuk është i drejtë. Së pari, është mohimi i të drejtës kushtetuese të votimit të emigrantëve që duhet të vinin, siç kanë ardhur çdo palë zgjedhje, nga Greqia apo Maqedonia. Me keqardhje konstatoj se një rol shumë negativ ka luajtur edhe një pjesë e KQZ-së, e cila ka refuzuar marrjen e provave për të hetuar në

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

mënyrë të plotë dhe shteruese denoncimet konkrete të sjella pranë KQZ-së. Së dyti, është shpërndarja e parave të rindërtimit, vetëm një javë para zgjedhjeve, që ka ndikuar në gjykimin tim në mënyrë të drejtpërdrejtë në prodhimin e këtij rezultati. Së treti, është përdorimi i të dhënave personale, të të gjithë zgjedhësve shqiptarë, në kundërshtim të plotë me gjithë legjislacionin në fuqi. Por, jo vetëm kaq, është dhe shantazhimi me shprehjen e Kryeministrit se, “Mos harroni se patronazhistët ju njohin mirë kush jeni”. Në gjykimin tim kjo jo vetëm që është e padrejtë, por duhet hetuar. Më tej akoma, qershia mbi tortë ishte propaganda e turpshme që bëri qeveria qendrore me vaksinat. Pra, “Na votoni ne sepse sigurojmë vaksina”. Nuk besoj se duhet të kishte.. çfarëdo lloj akti tjetër do t’ a zhbënte garën e barabartë. Për analogji ju sqaroj, ose biem dakord të gjithë se në një garë, qoftë edhe në një garë atletike, nëse ndonjë prej garuesve përdor doping, e thënë ndryshe substanca të ndaluara, sigurisht që rezultati që do të marrë ky atlet, do të jetë më i favorshëm, por nuk është ai rezultati real. Vetëm në një garë të barabartë midis palëve, ku asnjëra nga palët nuk merr avantazhe të padrejta, mund të prodhohet një rezultat zgjedhor i gjithëpranuar, sigurisht i pranuar dhe për mua si anëtar i këtij Komisioni Rregullator. Si përfundim të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator, për të gjitha arsyet e sipër përmendura.., vota ime është kundër miratimit të rezultatit të këtyre zgjedhjeve, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çakaj! Kolegë?! Po, zoti Caka.

Z. D. Çaka: Faleminderit zonja Kryetare! Atëherë, jemi mbledhur ketu, në këtë epilog të një procesi zgjedhor, i cili filloi që me aktin e dekretit të Presidentit të Republikës. Duhet theksuar që në mendimin tim, përbylli një proces, i cili kishte disa risi. Risi të cilat kishin të bënin që me një reformulim të një ndër strukturave kryesore të institucioneve që administrojnë procesin zgjedhor, siç

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

është Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe mendoj se të tre trupat e këtij institucioni kryesor për administrimin e zgjedhjeve ia arritën qëllimit të tij. Dua që në rradhë të parë të falenderoj gjithë kolegët në këtë tavolinë, që me punën që kemi nisur që në tetor, sapo kemi marrë mandatin dhe kemi bërë më të mirën tonë për të sjellë ato ndryshime në akte, të cilat i përshtaten Kodit Zgjedhor. Dua të falenderoj Komisionerin Shtetëror, për punën e palodhur gjatë këtij procesi, kolegët e KAS-it, pa harruar administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ata të cilët e administruan këtë proces në nivelin e bazës. Pra, siç janë anëtarët e komisioneve të qendrave të votimit, të vendeve të numërimit apo të zonave të administrimit zgjedhor. Pse bëra këtë falenderim?! Duhet theksuar që jemi të gjithë dakord që këto ishin zgjedhje që nga pikëpamja e administrimit të procesit zgjedhor ishin më të mirat që janë zhvilluar në këto vite demokraci në Shqipëri. Këtë jo se është mendimi im si një prej anëtarëve të trupave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, besoj se të gjithë i kemi parë edhe vlerësimet që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë, si nga organizata ndërkombëtare, të cilat e kanë monitoruar procesin zgjedhor, po ashtu edhe nga diplomatë të ndryshëm, të cilët e kanë vlerësuar punën, jo vetëm të Komisionit, akteve të miratuara prej tij, vullnetin e këtij Komisioni dhe besoj që bëmë më të mirën e mundshme. Secili prej nesh kuptohet që, ashtu siç edhe në çdo garë të themi, mund të ketë vlerësime personale për elementë të caktuar të këtij procesi. Në këndvështrimin tim këto ishin zgjedhje shumë të mira dhe më të mirat nga ato që ne kemi lënë pas në herët e tjera. Absolutisht që në këtë moment, të cilët ne jemi përpara këtij projektakti që na ka sjellë për miratim Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, duhet theksuar që janë ezauruar të gjitha rrugët e shqyrtimit të tij. Shqyrtimit administrativ nga KAS edhe nga Kolegji Zgjedhor. janë hapur kuti, janë bërë verifikime, të provave të pretendimeve që mund të kenë pasur të gjitha palët dhe në fund gjykata ka disponuar me një vendim. Si jurist jam gjithmonë i parimit që në momentin që gjykata është shprehur, ne të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

gjithë të tjerët jemi të detyruar që të zbatojmë vendimin e saj, dhe mos t'a interpretojmë. Kështu që duke shtuar votën time pro këtij projektakti, mendoj që në përfundim ishin zgjedhje të cilat dhanë një produkt të një Kuvendi, i cili është shumëngjyrësh dhe besoj që do të bëjë më të mirën për qeverisjen e vendit, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Çaka! Dakord, në përfundim të diskutimit në parim, edhe unë dua të them pak fjalë lidhur me projektaktin dhe me procesin pararendës të këtij projektakti. Jemi gati 80 ditë pas zgjedhjeve të 25 Prillit 2021. Në këto 80 ditë sigurisht që kemi patur procese të rëndësishme vendimmarrëse, si nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nga ana e Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe nga ana e Kolegjit Zgjedhor. Në mënyrë të përmbledhur unë do të ofroj për pjesëmarrësit, por edhe për publikun e interesuar, procesin 80 ditor vendimmarrje, ankimime deri në kolegji. Përshembull në rastin e Qarkut Lezhë, pas procesit të numërimit të votave KZAZ-të plotësuan, miratuan tabelat përmbledhëse të rezultateve dhe i depozituan në KQZ. Ky është një proces që ka ndodhur në të 12 qarqet. Në bazë të këtyre rezultateve Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, ka miratuar tabelën përkatëse të rezultateve për zonën zgjedhore të Qarkut Lezhë, në rastin konkret, e cila ka katër zona të administrimit zgjedhor. Në rastin e Qarkut Lezhë kemi një kërkesë ankimore në KAS, i cili vendosi pushimim e shqyrtimit të kërkesës ankimore dhe kundër vendimit të KAS nuk kemi ankim në Kolegjin Zgjedhor. Në Qarkun Fier janë depozituar kërkesa, qoftë në KAS, qoftë dhe në Kolegjin Zgjedhor nga subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë. Në Qarkun Gjirokastër kemi tre kërkesa ankimore nga disa subjekte, kërkesa të cilat janë shqyrtuar në KAS dhe më tej në Kolegjin Zgjedhor. Në Qarkun Korçë kemi dy kërkesa ankimore, të cilat kanë shkuar deri në Kolegjin Zgjedhor. Në Qarkun Vlorë kemi dy kërkesa ankimore të cilat gjithashtu janë shqyrtuar nga KAS dhe

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

Kolegji Zgjedhor. Në Zonën Zgjedhore Qarku Elbasan kemi kërkesë ankimore e cila është shqyrtuar në KAS dhe në Kolegjin Zgjedhor. Në zonën zgjedhore Qarku Tiranë kemi katër kërkesa ankimore, të cilat janë shqyrtuar në KAS dhe në Kolegjin Zgjedhor. Në Qarkun Shkodër kemi gjithashtu kërkesa që janë shqyrtuar në KAS dhe në Kolegjin Zgjedhor. Në Qarkun Dibër nuk ka paraqitur asnjë subjekt kërkesë ankimore. Në Qarkun Durrës kemi dy kërkesa ankimore, të cilat janë shqyrtuar në KAS dhe në Kolegjin Zgjedhor. Në Qarkun Berat kemi tre kërkesa ankimore të shqyrtuara në KAS dhe më tej në Kolegjin Zgjedhor. Në Qarkun Kukës nuk kemi kërkesa ankimore. Në përfundim të gjithë këtij procesi, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me 12 vendime ka vendosur shpërndarjen e mandateve mes subjekteve zgjedhore dhe përcaktimin e kandidatëve fitues në 12 qarqe, për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021. Ndaj këtyre vendimeve është ushtruar ankim, ka paraqitur kërkesë ankimore një subjekt zgjedhor, Koalicioni ABEOK. Kjo kërkesë nga KAS nëpërmjet vendimit nr.97, datë 29.06.2021, është vendosur mospranimi për shqyrtim i kësaj kërkesë. Kemi edhe vendimin e Kolegjit Zgjedhor të datës 09.07.2021, pra të ditës së premtë, e cila ka rrëzuar kërkesë-padinë. Pra, jemi në momentin kur ka përfunduar tërësisht procesi i ankimit administrativ dhe gjyqësor ndaj të gjitha vendimeve që lidhen me rezultatin e zgjedhjeve, në zonat zgjedhore, me shpërndarjen e mandateve. Theksova më sipër në rastin e vendimeve për shpërndarjen e mandateve kemi vetëm një kërkesë ankimore, pra vetëm nga një subjekt që ka marrë pjesë në zgjedhje. Kështu që unë mendoj që ajo ç'ka neni 167 i Kodit Zgjedhor kërkon nga ne është shpallja e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve. Në këtë kuptim vullnetin tonë për të miratuar ose jo këtë vendim, e konsideroj një vullnet të kushtëzuar nga gjithë procesi që përmenda më sipër dhe e konsideroj një rrjedhojë logjike, por edhe matematike të të gjithë proceseve vendimmarrëse dhe ankimore, të trajtuara pas zgjedhjeve deri ditën e premtë. Sipas rregullores u drejtohem përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore nëse kanë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

diçka për të diskutuar në parim lidhur me projektaktin. Zoti Kaso, përfaqësues i Koalicionit PD-AN.

Z. I. Kaso, përfaqësues i PD-së: Faleminderit e nderuar! Dy fjalë shkurt, pasi një pjesë e mirë e diskutimeve u ezauruan nga ana juaj në diskutimin në parim të aktit. Vendimmarja e sotme dhe akti që është për diskutim edhe sot në tryezën tuaj është shumë i rëndësishëm, pasi dhe formalisht është akti i fundit që ka të bëjë me procesin zgjedhor të datës 25 Prill dhe konkludoni të gjitha procedurat ligjore që lidhen me të. Por, jo detyrimisht përfundon le të themi gjithë procesi zgjedhor, proces i cili jam i sigurt që do të vazhdojë me vlerësime të vëzhguesve shqiptarë dhe atyre ndërkombëtarë për procesin zgjedhor, të cilat priten të dalin së shpejti. Pse jo, është në shpresën e të gjithë shqiptarëve që me veprime aktive edhe të agjensive ligjzbatuese lidhur me problematikat e rënda nga i cili vuajti procesi që sapo lamë pas. Nuk jam dakord me ju mbi atë që sapo thatë. Shpreh këtu këndvështrimin tonë si subjekt, lidhur me faktin që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, është i kushtëzuar sot në vendimmarrjen e tij dhe se kjo vendimmarrje është krejt formale. Pra, pasi duhet të vijë si rrjedhojë juridike e një sërë vendimmarrjesh, të cilat e kanë ezauruar tashmë efektin e tyre. Vlerësoj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Rregullatori në këtë rast duhet të ngrihet në lartësinë e detyrës së vet dhe në pritshmërinë e gjithë shqiptarëve, që organi përgjegjës për organizimin, administrimin e procesit zgjedhor, të mbajë më në fund një qëndrim ligjor të qartë, lidhur me vlerësimin që vetë ky organ i jep procesit zgjedhor që sapo lamë pas. Vlerësimi nuk mund të bëhet kurrë më mirë dhe në asnjë moment tjetër më mirë sesa në këtë rast, duke u shprehur me votë. Nëqoftëse procesi zgjedhor që sapo lamë pas i përmbushte jo vetëm aspiratat dhe pritshmëritë e shqiptarëve dhe të partnerëve ndërkombëtarë, por mbi të gjitha ato standarte ligjore, ato standarte etike dhe morale për të cilat të gjitha palët u përkushtuan

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

në tryezë përpara se procesi zgjedhor të fillonte dhe qartazi u shkelën me këmbë dhe u grisën ditën për diell nga mazhoranca mbasi u miratuan bashkarisht. Është një proces i cili dha shenja të mbara bashkëpunimi në momentin që konsensusi aq shumë i kërkuar dhe i vënë kusht Shqipërisë në rrugën e procesit të integritimit europian u materializua me një tryezë politike e cila duhet të rregullonte në ligj, të rregullonte në letër, të vendoste standarte mbi ato çfarë nuk kishin funksionuar, veçanërisht në zgjedhjet e fundit dhe cilat ishin plagët më të rënda nga i cili vuante procesi zgjedhor. Është një proces që ndonëse i vendosi këto standarte dhe ndonëse i vendosi këto piketa me konsensus, përsëri në funksion të arritjes së një rezultati konkret, atë të grabitjes së procesit zgjedhor edhe njëherë nga shqiptarët dhe dhënia me nënkontraktim e krimit të organizuar, e oligarkëve dhe e funksionarëve të tjerë të lidhur ngushtë me pushtetin, nga ana e mazhorancës në pushtet, bëri që ky proces të deformathej nga një garë e barabartë, në një garë në të cilën, të gjitha subjektet që nuk kishin qeveri, garonin jo kundër mazhorancës, por garonin kundër gjithë forcës së pushtetit. Garonin kundër gjithë resurseve dhe burimeve të shtetit. Është një proces i cili duhet të shqetësojë shumë gjithë shqiptarët, gjithë partnerët ndërkombëtarë, por mbi të gjitha duhet t'ju shqetësojë juve si administratorë të procesit zgjedhor. Kemi qenë të gjithë këtu dëshmitarë, siç e thanë dhe kolegët tuaj të nderuar, kur vendimmarrje shumë të rëndësishme të marra nga ana juaj, në zbatim të parashikimeve që për herë të parë janë në Kodin Zgjedhor, të cilat synonin të parandalonin pikërisht atë shkrirje dhe bërje njësh të partisë në pushtet me burimet dhe resurcet e mëdha dhe të pabarabarta shtetërore. Nuk u morën parasysh, u shkelën ditën për diell, madje sot ka dhe vendimmarrje gjykatash që certifikojnë në mënyrë të pakonceptueshme që vendimmarrjet tuaja janë shkelur dhe parashtrimet ligjore janë shkelur. Qëndrimi që duhet të mbajë sot Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, organi më i lartë që menaxhon zgjedhjet, nuk mund të jetë qëndrimi i një zgjedhësi shqiptar tashmë të lënë pa asnjë armë dhe pa asnjë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

shpresë, ku në kafene thotë “Nuk kemi çfarë t’i bëjmë”. Sigurisht që kemi çfarë t’i bëjmë, sigurisht që kemi çfarë t’i bëni dhe minimalja që mund të bëni është që të ngriheni në pritshmërinë e të gjithë shqiptarëve dhe të shprehni kontestimin tuaj me votë ndaj një procesi thellësisht të parregullt, të një procesi thellësisht të deformuar, ndaj një procesi në të cilin gjithëshka prevaloi, por jo vullneti i lirë dhe sovran i shqiptarëve, por interesat e partisë në pushtet dhe të mazhorancës në pushtet, për të siguruar me çdo kusht dhe në çdo mënyrë të jashtëligjshme një mandat të tretë. Prandaj kërkoj nga ana juaj që të reflektoni thellë mbi rëndësinë e vendimmarrjes tuaj të sotme, që mos t’a konsideroni si një vendimarrje formale të cilës edhe ju nuk keni çfarë t’i bëni, por të paktën të jepni një shenjë që administratori i zgjedhjeve, garanti i zgjedhjeve në Shqipëri, minimalisht është thellësisht i shqetësuar për çfarë ka ndodhur. Më pas fjalën siç e thashë në fillim të parantezës time do t’a kenë organet ligjzbatuese, të cilët shumë shpejt besoj do të thonë fjalën e tyre mbi deformimet e rëndësishme që kanë ndodhur në këtë proces, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Kaso! Përfaqësues të subjekteve të tjera zgjedhore, po zoti Kaziaj, përfaqësues i LSI-së.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Faleminderit zonja Kryetare! Të nderuar anetarë të këtij Komisioni, kjo është mbledhja juaj e fundit që bëni, lidhur me një projektvendim kaq të rëndësishëm, siç është shpallja e rezultit përfundimtar të zgjedhjeve, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të paktën për këtë proces. Së pari, dua të falenderoj një pjesë të mirë të KQZ-së, administratën e saj, e cila na ka vënë në dispozicion, me korrektesë aktet dhe të gjithë materialet paraprake, në mënyrë që ne, përfaqësuesit e subjekteve politike të bënim oponentin ose të jepnim dakordësinë tonë lidhur me to, jo vetëm pranë këtij Komisioni, por qoftë edhe pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

dhe pranë Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Falenderoj Nënkrjetaren, Nënkomisionere në këtë rast, e cila me shumë impenjim implementoi teknologjinë në zgjedhje, ndonëse gjetjet e tjera nga kjo teknologji u interpretuan si të tilla në bazë të ankimimeve të bëra nga ana jonë pranë Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve për shkaqe, të themi, të ngritjes së kartonit nga ana e tyre, nga tre anëtarët e subjektit politik nga i cili ishin zgjedhur. U interpretuan si jo të rëndësishme. Ftojme këtu organin procedues me gjithë denoncimet e bëra që të procedojë me integritet duke nxjerrë dhe duke zbardhur ngjarjet përkatëse, në të gjithë Republikën e Shqipërisë. Gjej dakordësi me kolegët Vukaj dhe Çakaj për sa i përket qëndrimeve të mbajtura, që janë qëndrime të bazuara mbi prova tashme të bëra publikisht, nga ana jo vetëm e subjekteve politike të opozitës, por edhe të organizatave të cilat nuk kanë karakter politik, qofshin kombëtare apo ndërkombëtare në Shqipëri. Gjej dakordësinë me ato që tha kolegu Kaso për sa i përket pjesës që bënë oponencë atë që ju zonja Kryetare sapo cituat, që “Është thjesht një formalitet kjo mbledhje”. Në të vërtetë nuk është një formalitet. Gjej rastin t’ju ftoj që me integritet të jepni, le të themi, qëndrimin tuaj lidhur me këtë projektvendim, duke marrë në konsideratë faktin që një pjesë e mira e juaj është prind. Jeni baballarë dhe nëna të fëmijëve. Në qoftë se do i mësojmë fëmijëve tanë që në këtë republikë mund të bësh çfarë të duash, mund të organizosh gjithë makinerinë shtetërore për të arritur një qëllim deri diku të pamërituar. Nuk gjej dakordësi me zotin Çaka, i cili thotë “Këto janë zgjedhjet më të mira të realizuara ndonjëherë”. Këto zgjedhje u panë se si u realizuan zoti Çaka. Normalisht ju jeni mbrojtës i një subjekti politik, pavarësisht se jeni zgjedhur nga parlamenti dhe mbani këtë qëndrim. Nuk e ndaj këtë qëndrim me ju. Ju nuk jeni prind akoma, unë jam prind i dy fëmijëve dhe nuk dua që fëmijëve të mi t’u them se këto ishin zgjedhjet më të mira. Nuk kam se si t’ia them. Zgjedhjet u panë që nga ankimimet e bëra nga subjektet politike. Zgjedhjet u panë se si i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

vlerësoi këto zgjedhje një komision tjetër kolegjal i përbërë nga persona të mazhorancës shqiptare, të cilët interpretuan jashtë frymës së ligjvënësitet dispozita të caktuara mbi vlerësimin e votës dhe normalisht nxorrën rezultatin që ju telekomandua për të nxerrë. Pra, ndodhemi sot në këtë Komision, normalisht ky Komision u formalizua në bazë të ndryshimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, mbas atyre që ishin konsensusi i partive politike në Këshillin Politik, të nxjerra nëpërmjet ligjit, të formalizuara dhe të formatuara në ligj, nëpërmjet Ligjit 101/2020. Ligj i shkelur dhe konsensus i shkelur me të dyja këmbët nëpërmjet Ligjit 118/2020. Këtë gjë nuk po e them më unë si përfaqësues i një subjekti politik. Nuk do të mbaja qëndrim politik.. Thashë, para të ardhmes së fëmijëve të mi nuk vë as partinë e cila më ka caktuar që t'a përfaqësoj pranë këtij institucioni dhe kjo të jetë e qartë. Këtë gjë e ka thënë dhe Gjykata Kushtetuese dhe do të doja një reflektim nga ana juaj. Të prisni shpalljen e një vendimi të marrë jo më larg se një javë më parë nga Gjykata Kushtetuese dhe pastaj të shpreheni me vendim lidhur me miratimin e rezultatit final. Nëqoftëse ky vendim i Gjykatës Kushtetuese Shqiptare ndikon ose themi prek atë pjesë të dispozitës së shfuqizuar, ju mund të shpreheni në një moment të dytë dhe jo sot. Ju faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Kaziaj! Zoti Sulo?

Z. Sh. Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Faleminderit e nderuar Kryetare! Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator, tashmë zgjedhjet mbaruan dhe nuk ka rëndësi se kush ishte rezultati i zgjedhjeve apo kush fitoi. Më e rëndësishme është se çfarë u arrit në këto zgjedhje? U votua lirshëm, u respektua vullneti i zgjedhësve? A u kënaqën ndërkombëtarët me vërejtjen që na kanë bërë prej kohësh për sistemin zgjedhor që ne inplementojmë?! Për mua absolutisht jo. Edhe pse me shumë bujë u miratua ky Kod Zgjedhor, edhe pse me një ritëm

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

shumë të shpejtë, ajo Kushtetutë e shkretë u kafshua ku deshën, si deshën, por përsëri për opinionin tim zgjedhjet nuk ishin të lira dhe aq më shumë të pastra. Edhe po të pyesësh atë shtresë që çuditërisht doli në këto zgjedhje patronazhistët e famshëm, që veç ligjërimi që i bëri qeveria, edhe ata nuk janë dakord se si u zhvilluan zgjedhjet. Referuar Kodit Zgjedhor dhe konkretisht nenit 3, zgjedhjet erdhën me votën e lirë, të fshehtë, të barabartë dhe të drejtpërdrejtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë kod. Zgjedhësit të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre për të votuar. Por a ndodhi realisht kjo në këto zgjedhje?! Absolutisht jo! Problemi më i madh dhe më i rëndësishëm i shoqërisë dhe i shtetit tek ne nuk ka qenë asnjëherë mungesa e ligjit, e rregullit, aktualisht e rregullit të hartuar keq. Problemi qëndron tek moszbatimi i ligjit. Problemi qëndron tek arroganca e tyre, që për shkak të mundësisë për t'iu shmangur përgjegjësive, dhënies së llogarisë, janë kthyer autokratë mesjetar me mendimin që, “këtu vendosim ne, bëjmë si duam ne, ligji jam unë” siç ndodhi faktikisht me qeverinë. Por a arriti organi i KQZ-së të ishte pjesë garantuese e një procesi zgjedhor ligjor? Vështirë të thuash po, pasi me vendimet e saj nuk arriti të ndalonte shkeljet flagrante të kodit, ato të cilat u cituan edhe nga parafolës të tjerë. Votimi me më shumë se një herë nga një person apo aparaturat e famshme të identifikimit biometrik që siç duket, në një pjesë të mirë, në disa qendra votimi u lodhën nga vapa dhe nuk punonin. Më e çuditshmja ishte, numrin rekord i fletëve të pavlefshme. Në këtë rast në asnjë moment nuk patëm një prononcim të qartë nga institucioni i KQZ-së. E nderuar Kryetare ne kemi drejtues të KQZ-së që kanë aq vite në krye të saj sa Kosova është bërë shtet, por në asnjë rast në shtetin shqiptar të Kosovës këto çudira dhe këto shkelje që kanë ndodhur tek ne, nuk kanë ndodhur aty. Nuk e di çfarë do të ndodhë nesër, do të ndryshojë sistemi, do të bëhet votimi elektronik, do t'u jepet mundësia emigrantëve të votojnë apo nga institucionet e huaja ndërkombëtare do të na japin ndonjë sistem të gatshëm zgjedhor ku mos të kemi ndonjëherë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

zgjedhje të jashtëligjshme. Madje mund të them që besimi në institucionin që organizon zgjedhjet është vuarë. Ky është mendimi im personal. Ndoshta ndonjëherë do të bëhen zgjedhje të lira, të pastra, le të shpresojmë, pasi shpresa vdes e fundit. Ndoshta për shqiptarët në zgjedhjet e ardhshme, dita kur do të shkojnë për të votuar, mos të jetë një makth, por të jetë një ditë rutinë, e çastit ku të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre për të votuar, shpresojmë, faleminderit.

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Sulo! Ka përfaqësues të tjerë të subjekteve? Po zoti Salianji, përfaqësues i subjektit zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë

Z. E. Salianji, përfaqësues i PS-së: Faleminderit! Për sa i përket diskutimit të këtij projektakti, i cili është një akt formal që përmbyll një proces të gjatë zgjedhor, ankimor dhe shpall rezultatin përfundimtar. Përpara se të diskutoj në parim për aktin, së pari do të shprehja një falenderim për organizatorët e këtij procesi. Organizatorët kryesorë, të cilët janë komisionerët e zgjedhjeve, të tre forcave politike, si të mazhorancës dhe të opozitës. Mbi 20.000 komisionerë miradministruan procesin dhe nga i gjithë ky proces nuk pati asnjë problem. Është procesi i parë në të cilin komisionerët në punën e tyre nuk i kanë sjellë asnjë problem zgjedhjeve, si dhe vetë institucionit të KQZ-së. Një falenderim të veçantë kam për stafin e KQZ-së dhe drejtuesit e saj, si Komisioneri dhe Nënkomisioneren, të cilët organizuan procesin zgjedhor, si dhe vunë në punë e zbatuan atë detyrim të Kodit Zgjedhor, një risi që ishte, identifikimi elektronik. I cili ishte shumë i rëndësishëm për këtë proces, që i shërbeu transparencës së procesit zgjedhor dhe në mënyrë të veçantë hoqi gjithë dyshimet që në një qendër votimi mund të votohet më shumë se një herë. Një falenderim kemi edhe për aktorët politikë. Është një fushatë e gjatë zgjedhore, pavarësisht debateve politike dhe fushatës elektorale. Besoj në këto zgjedhje aktorët politikë kanë qënë dhe të përmbajtur dhe kanë zhvilluar një fushatë serioze, në të cilën solli


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.13.07.2021*

